

Rekomandimet e pjesëmarrësve të Paneleve Qytetare për zhvillimin e turizmit rural dhe malor



REKOMANDIMET E PJESËMARRËSVE TË PANELEVE QYTETARE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT RURAL DHE MALOR

Konteksti

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), së bashku me Involve UK, ka zbatuar metodologjinë deliberative të “Paneleve Qytetare: Një mënyrë e re për t’u angazhuar në proceset Parlamentare” përmes një aktiviteti tre ditor në Tiranë gjatë datave 17-19 tetor. Panelet Qytetare njihen si një praktikë e mirë ndërkombëtare që mundëson krijimin e një hapësire për diskutimin në mënyrë të informuar të çështjeve që janë në axhendën parlamentare, si dhe kontribuojnë në forcimin e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në aktivitetin legjislativ dhe mbikëqyrës të parlamentit.

Përgjatë tre ditëve, rreth 10 ekspertë të fushës dhe moderatorë me përvojë lehtësuan diskutimet e qytetarëve pjesëmarrës në Panelet Qytetare mbi sfidat dhe prioritetet e zhvillimit të turizmit rural dhe malor. Rreth 50 qytetarë të përzgjedhur rastësisht nga i gjithë vendi u informuan në mënyrë objektive nga ekspertë të fushave të turizmit rural dhe malor dhe më pas formuluan rekomandimet për këtë çështje. Rekomandimet që kanë dalë si rezultat i këtij ushtrimi trajtojnë prioritetet që lidhen me ndikimin ekonomik dhe kuadrin rregullator mbështetës për turizmin rural dhe malor; diversifikimin e shërbimeve turistike dhe rivitalizimi i zonave rurale dhe malore; si dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe zhvillimin e turizmit.

Kjo nismë është në kuadër të projektit “Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Instituti Shqiptar i Shkencës dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike.

TEMATIKA: RËNDËSIA EKONOMIKE DHE KUADRI RREGULLATOR MBËSHTETËS PËR TURIZMIN RURAL DHE MALOR

REKOMANDIMI 1: FORCIMI I BURIMEVE NJERËZORE SI KOMPONENT KRYESOR NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT MALOR DHE RURAL

Ne besojmë se burimet njerëzore janë një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin dhe konkurrencën në tregun e turizmit, veçanërisht në zonat rurale dhe malore, ku ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Emigrimi i lartë nga komunitetet rurale, në mënyrë të veçantë ato malore, jo vetëm që e tkurr potencialin ekonomik, por rrezikon edhe zhdukjen e traditave dhe praktikave autentike, të cilat janë të rëndësishme për tërheqjen e turistëve dhe promovimin e turizmit. Popullata e larguar merr me vete jo vetëm kapacitetin dhe potencialin e tyre krijues dhe prodhues, por dhe trashëgiminë kulturore të komunitetit.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Krijimi i politikave fiskale lehtësuese dhe nxitëse të cilat ofrojnë lehtësira tatimore për bizneset ekzistuese dhe ato të reja në këto zona për të nxitur punësimin dhe zhvillimin ekonomik vendor.
2. Përmirësimi i shërbimeve publike bazë përmes investimeve në infrastrukturë, shëndetësi dhe arsim për të garantuar cilësi jete më të mirë dhe për t'i bërë këto zona më tërheqëse për banorët, në mënyrë të veçantë për të nxitur rikthimin e popullatës së larguar, sidomos të rinjve.
3. Aplikimi i programeve nxitëse të punësimit në përshtatje me nevojat e tregut të turizmit, duke përfshirë organizimin e trajnimeve profesionale për forcën aktuale të punës.
4. Ofrimi i mbështetjes për start-upe dhe sipërmarrje lokale përmes financimit të skemave specifike për to.
5. Hartimi i paketave mbështetëse për bizneset familjare në këto zona, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik vendor.

6. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse të popullatës lokale mbi rëndësinë e turizmit në zhvillimin ekonomik dhe social të këtyre zonave.
7. Zbatimi i projekteve pilot në zona specifike për të testuar dhe analizuar efektivitetin e masave të propozuara dhe për të përshkallëzuar zgjidhjet e suksesshme në zonat malore të tjera në vazhdimësi.

Deklaratë:

Burimet njerëzore përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrencën në sektorin e turizmit, veçanërisht në zonat rurale dhe malore. Këto zona mbartin trashëgimi të pasur kulturore dhe tradita autentike që, në mungesë të mbështetjes së duhur, rrezikojnë të humbasin. Për këtë arsye, ne theksojmë rëndësinë e zbatimit të masave të propozuara për të përmirësuar jetën në komunitetet malore dhe për të forcuar burimet njerëzore si komponent kryesor në zhvillimin e turizmit malor dhe rural.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit që është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale lehtësuese dhe nxitëse për bizneset ekzistuese dhe ato të reja në zonat rurale dhe malore, si dhe për ofrimin e skemave financiare për të start-upet dhe sipërmarrjet lokale.
- Ministrinë e linjës: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit.
- Sektori i shoqërisë civile, sektori privat dhe media.

REKOMANDIMI 2: PROMOVIMI DHE MBROJTJA E PRODUKTEVE LOKALE

Ne besojmë se çështja e promovimit dhe mbrojtjes së produkteve lokale është e rëndësishme sepse:

- Së pari, produktet lokale janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe identitetit të komuniteteve rurale dhe malore.
- Së dyti, ato luajnë një rol kryesor në diferencimin e destinacioneve turistike dhe në krijimin e përvojave autentike për vizitorët.
- Së treti, promovimi dhe mbrojtja e produkteve lokale lidhet direkt me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në ruajtjen e traditave.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Identifikimi, ruajtja dhe brandimi i produkteve lokale përmes zbatimit të mekanizmave ligjorë për mbrojtjen dhe promovimin e produkteve tradicionale dhe të territorit bazuar në legjislacionin për Pronësinë Industriale.
2. Mbështetje për fermerët apo grupet e fermerëve me asistencë teknike dhe financiare në regjistrimin dhe certifikimin e produkteve tradicionale apo të territorit sipas skemave të cilësisë, si Tregues Gjeografik dhe Specialitete Tradicionale të Garantuara.
3. Rritja e atraktivitetit të zonave turistike përmes promovimit të produkteve lokale si ambasadorë të rajonit për të nxitur eksportet dhe rritur interesin turistik në këto zona.
4. Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e farave autoktone të bimëve mjekësore dhe resurseve të tjera gjenetike me rëndësi për biodiversitetin dhe turizmin.
5. Njohja dhe mbështetja e fermerëve dhe blegtorëve që përdorin fara origjinale ose raca autentike, duke siguruar që ky status të koordinohet me skemat ekzistuese të subvencioneve për të shmangur mbivendosjet.
6. Organizimi i panairove dhe aktiviteteve promovuese për artizanët që kontribuojnë në pasurimin e ofertës turistike përmes produkteve autentike.
7. Fuqizimi i rolit të institucioneve si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) për të siguruar që produktet lokale plotësojnë standardet dhe për të mbrojtur prodhuesit nga praktikatat e pandershme tregtare.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Institucione të varësisë: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit.
- Sipërmarrjet lokale dhe grupet e prodhuesve duke bashkëpunuar ngushtësisht me njëri tjetrin.

Deklaratë:

Vendi ynë është i pasur me produkte lokale unike të tilla si bujqësore, blegtorale, produkte ushqimore dhe gatime tradicionale, të cilat mishërojnë bashkëpunimin ndërmjet burimeve natyrore dhe traditës së komuniteteve lokale. Nëse duam të ruajmë këto produkte, ushqimin tonë tradicional, zakonet tona të kuzhinës, identitetin dhe traditën dhe në të njëjtën kohë të ofrojmë konkurrencë të barabartë në treg, është e domosdoshme mbrojtja e produkteve nëpërmjet regjistrimit zyrtar të tyre. Mbështetja për zhvillimin dhe regjistrimin e këtyre produkteve është një sfidë që kërkon kujdes, kohën e nevojshme për zhvillim, përkushtim dhe profesionalizëm. Masat e propozuara do të ndihmojnë në ruajtjen e trashëgimisë lokale dhe përforcimin e pozicionit konkurrues të zonave rurale dhe malore si destinacione turistike.

REKOMANDIMI 3: PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE, DIXHITALE DHE LOGJISTIKE PËR TURIZMIN MALOR

Ne besojmë se çështja e infrastrukturës së përmirësuar për turizmin rural dhe malor është e rëndësishme sepse:

- Së pari, mungesa e investimeve të duhura në infrastrukturë përkeqëson edhe më tej situatën sociale dhe ekonomike të komuniteteve rurale dhe malore për shkak të izolimit dhe largimit të rinjve nga zonat rurale, duke penguar në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik vendor.
- Së dyti, pa infrastrukturë të mirëfilltë, nuk mund të krijohet një produkt konkurrues për tregun e turizmit, duke humbur kështu mundësinë për të tërhequr vizitorë dhe për të zhvilluar potencialin turistik të zonave rurale dhe malore.
- Së treti, përmirësimi i infrastrukturës ndikon drejtpërdrejt në rritjen e numrit dhe diversifikimin e vizitorëve, duke përfshirë grupe me mundësi të ndryshme ekonomike dhe aftësi të kufizuara (PAK) si dhe në përmirësimin e përvojës turistike, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale.
- Së katërti, mungesa e infrastrukturës cilësore jo vetëm që kufizon zhvillimin e turizmit, por rrit rrezikun e aktiviteteve turistike të pakontrolluara që shpesh shkelin parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe dëmtojnë pasuritë natyrore.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Krijimin e politikave fiskale që përfshijnë lehtësira në tatimet dhe taksat për investitorët dhe operatorët turistikë që investojnë në infrastrukturën e qëndrueshme dhe turizmin rural dhe malor. Incentivat financiare duhet të targetojnë krijimin dhe zgjerimin e bizneseve të vogla, të tilla si bujtina, guida turistike, dhe shërbimet e agroturizmit, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e komuniteteve lokale.
2. Krijimi i një fondi të posaçëm për turizmin rural dhe malor për të mbështetur nisma lokale dhe banorët që kërkojnë të zhvillojnë bizneset e tyre turistike. Ky fond mund të bashkëfinancohet nga donatorë ndërkombëtarë dhe qeveria shqiptare për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm.
3. Përmirësimi i aksesit dhe infrastrukturës rrugore:
 - » Institucionet qendrore përkatëse në bashkëpunim me autoritetet lokale duhet të hartojë një plan kombëtar për përmirësimin e rrugëve që lidhin zonat malore dhe rurale, si dhe me qendrat kryesore turistike dhe zbatimin e këtij plani.
 - » Ndërtimi i rrjeteve të transportit publik që lidhin qytetet me zonat e largëta malore dhe rurale do të lehtësojë lëvizjen e turistëve dhe do të sigurojë qasje të lehtë dhe të përballueshme. Për shembull, mund të krijohet linja autobusi dhe mikrobuzi që operojnë midis destinacioneve kryesore dhe fshatrave malorë, duke reduktuar ndotjen dhe duke siguruar transport më të qëndrueshëm.
4. Krijimi i një infrastrukture informatike të fortë:
 - » Krijimi i një platforme dixhitale kombëtare për turizmin rural dhe malor që ofron informacion të përditësuar mbi destinacionet turistike, udhërrëfyes dixhitalë, dhe harta interaktive që ndihmojnë turistët të planifikojnë dhe rezervojnë udhëtimet e tyre në këto zona.

- » Instalimi i internetit me brez të gjerë është një domosdoshmëri për këto zona, duke ndihmuar turistët të kenë qasje në informacion dhe rezervime në kohë reale, duke lehtësuar menaxhimin dhe promovimin e destinacioneve nga operatorët turistikë lokalë.
5. Krijimi i një plani afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të këtyre zonave malore dhe rurale, përmes një infrastrukture të centralizuar mbi investimet afatgjata. Ky plan duhet të përfshijë projekte të integruara për turizmin, bujqësinë dhe mbrojtjen e mjedisit, për të krijuar një ekosistem ekonomik të qëndrueshëm që mbështet bizneset lokale dhe ruan mjedisin natyror.

Deklaratë:

Zhvillimi i një programi të integruar për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, dixhitale dhe logjistike është i rëndësishëm për rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale të komuniteteve rurale dhe malore në Shqipëri. Pa investime në këto fusha, zonat rurale dhe malore mbeten të izoluar, duke kufizuar zhvillimin ekonomik dhe duke nxitur largimin e popullsisë së re. Një infrastrukturë cilësore është e nevojshme për të tërhequr vizitorë dhe promovuar ruajtjen e pasurive natyrore dhe kulturore të këtyre zonave.

Ne besojmë se përmes një programi të integruar që inkurajon investime publike dhe private, do të përmirësohet aksesimi, informimi dhe përvoja turistike, duke ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre zonave.

TEMATIKA: DIVERSIFIKIMI I SHËRBIMEVE TURISTIKE DHE RIVITALIZIMI I ZONAVE RURALE DHE MALORE

REKOMANDIM 4: HARTIMI I PLANEVE VENDORE PËR TURIZMIN

Ne besojmë se hartimi i Planeve Vendore për Turizmin është i rëndësishëm sepse:

- Së pari, planifikimi i turizmit në nivel lokal siguron që burimet territoriale të përdoren në mënyrë të qëndrueshme, pa u degraduar ose shkatërruar. Planifikimi do të mbronte peisazhet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe biodiversitetin që janë të rëndësishme për tërheqjen e turistëve.
- Së dyti, plani vendor për turizmin mund të ndihmojë në koordinimin e investimeve në infrastrukturë, duke përfshirë rrugët, furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji, objektet e akomodimit dhe shërbimet turistike. Si rrjedhim, cilësia e përvojës turistike do të rritet dhe kapaciteti i zonës do të përmirësohet për të përballuar flukset e turistëve.
- Së treti, plani ndihmon në promovimin e zhvillimit ekonomik përmes mbështetjes së bizneseve vendore, krijimit të vendeve të punës dhe nxitjes së sektorëve të tjerë, si bujqësia, artizanati dhe shërbimet lokale që mbështesin turizmin.
- Së katërti, plani lejon menaxhimin më mirë të flukseve të turistëve në mënyrë që të shmangen mbipopullimi dhe presionet mbi infrastrukturën dhe burimet vendore.
- Së fundmi, përmes planit vendor, mund të zhvillohet strategji për të ruajtur traditat, zakonet dhe kulturën lokale, duke e bërë turizmin një mjet për përmirësimin e vlerave kulturore dhe jo për degradimin e tyre.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Hartimi i planeve duhet të nisë me një vlerësim të detajuar të burimeve turistike, përfshirë resurset natyrore, kulturore dhe historike që mund të shfrytëzohen për të tërhequr turistë.
2. Identifikimi i zonave që kanë potencial të lartë për zhvillim turistik, si dhe përcaktimi i zonave të tjera që duhet të mbrohen për të shmangur ndërtimet e pakontrolluara ose ndikimet negative.
3. Përcaktimi i infrastrukturës së nevojshme për të përballuar kërkesën e turistëve. Kjo përfshin rrugë, ujësjellës, kanalizime, dhe objekte akomodimi që përputhen me standardet e cilësisë dhe qëndrueshmërisë.

4. Marrja e masave për të siguruar që turizmi nuk dëmton ekosistemet dhe që burimet natyrore përdoren në mënyrë të përgjegjshme. Përfshirja e qasjeve për reduktimin e mbetjeve dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme është e rëndësishme.
5. Angazhimi i komunitetit lokal në procesin e planifikimit dhe zbatimit të planeve të turizmit është i rëndësishëm për të siguruar që përfitimet të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe që trashëgimia kulturore vendase të ruhet.
6. Përfshirja në planet e turizmit të strategjive të marketingut për të promovuar destinacionet turistike, si dhe për të tërhequr tregje të reja të turistëve.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila luan rolin kryesor në përcaktimin e politikave kombëtare për turizmin dhe mbikëqyrjen e planeve vendore, duke siguruar që ato të përputhen me strategjitë kombëtare.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për turizmin.
- Sektori privat dhe organizatat joqeveritare: Bashkëpunimi me sektorin privat dhe sektorin e shoqërisë civile është i nevojshëm për të siguruar financimin dhe zbatimin efektiv të projekteve, si dhe për të garantuar që strategjitë përfshijnë përfitime për komunitetet vendore.

Deklaratë:

Hartimi i Planeve Vendore për Turizmin është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin efikas të burimeve lokale. Këto plane janë thelbësore për të siguruar që turizmi kontribuon në zhvillimin ekonomik, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe mirëqenien e komuniteteve. Për këtë, duhet bashkëpunim dhe koordinim të mirë midis institucioneve publike në të gjitha nivelet dhe aktorëve lokalë për ta kthyer turizmin në një mjet për zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm.

REKOMANDIMI 5: PËRMIRËSIMI I NJOHJES DHE PROMOVIMIT TË PRODUKTEVE AUTENTIKE DHE TË TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM DUKE VALORIZUAR ATË QË ËSHTË E PËRVEÇME DHE AUTENTIKE NË SHQIPËRI.

Ne besojmë se çështja e njohjes, forcimit dhe promovimit të autenticitetit dhe trashëgimisë kulturore vendase është e rëndësishme sepse:

- Së pari, është një nga mënyrat më të shëndetshme për të vendosur balancë mes nevojës për të tërhequr sa më shumë turistë (kryesisht të huaj, por jo vetëm) dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe elementëve autentike shqiptare. Kjo ndihmon turizmin të mos shndërrohet në një aktivitet uniform, por të ofrojë përvoja unike që pasqyrojnë identitetin kombëtar.
- Së dyti, mbështetja dhe promovimi i produkteve autentike/tradicionale ndihmon në fuqizimin ekonomik dhe social-kulturor të komuniteteve vendore. Në këtë mënyrë ata incentivohen për të vazhduar ruajtjen e traditave të zonave përkatëse.

- Së treti, mbështetja ndaj produkteve autentike dhe aktiviteteve lokale krijon mundësi ekonomike për komunitetet rurale dhe malore, duke i mbajtur vendasit të angazhuar në veprimtari prodhuese dhe turistike. Kjo ndihmon në parandalimin e shpopullimit dhe në krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për këto zona.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Pasurimi i kurrikulave shkollore me lëndë dhe module që nxisin njohjen dhe promovimin e autenticitetit shqiptar, duke shmangur ngarkesat teorike dhe duke u fokusuar në aktivitete njohëse dhe qasje praktike.
2. Planifikimi dhe organizimi i rregullt i aktiviteteve promovuese (si p.sh. tregje, panaire të produkteve autentike/tradicionale) në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar (me shpeshtësi që varion sipas nivelit dhe mundësive).
3. Përfshirja e produkteve dhe elementeve të traditës shqiptare në paketat turistike të ofruar nga operatorë dhe guida turistike në vend. Kjo mund të mundësohet përmes propozimit të mekanizmave rregullatorë si kushtëzimi i licencave apo propozimi i instrumenteve të tjerë nxitëse.
4. Krijimi dhe akordimi i një statusi të veçantë për individët, biznese apo organizata që kontribuojnë drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe promovimin e produkteve dhe praktikave autentike shqiptare (të tillë fermerët që ruajnë dhe kultivojnë varietete lokale, blegtorë që mbarështojnë racat lokale, gurpunues, leshpunues, artizanë të kostumeve popullore etj.). Ky status duhet të përfshijë incentiva specifike dhe të sigurohet transparencë në dhënien e tij për të shmangur paraktikat abuzive.
5. Ofrim i mbështetjes financiare dhe infrastrukturore për shoqatat e artizanëve dhe organizatat që punojnë në fushën e njohjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe produkteve autentike shqiptare.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit.
- Universiteti Bujqësor i Tiranës, Instituti për Resurset Gjenetike të Bimëve.

Deklaratë:

Njohja, ruajtja dhe promovimi i autenticitetit shqiptar është mënyra e duhur për të ndërlidhur turizmin dhe bujqësinë, dhe për më tepër, për të siguruar qëndrueshmërinë ekonomike dhe social-kulturore të zonave rurale dhe malore në vend. Pa mbështetjen dhe promovimin e tij, banorët e këtyre zonave nuk do kenë motivim për qëndruar dhe për pasojë do të përshpejtojnë fenomenin e shpopullimit. Duke edukuar mbi vlerat autentike shqiptare, mbështetur individë dhe shoqata që promovojnë dhe trashëgojnë këto elementë, ne mund të fuqizojmë komunitetet lokale si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social-kulturor.

REKOMANDIMI 6: PËRFSHIRJA E TË RINJVE NË SIPËRMARRJE TURISTIKE

Ne besojmë se, pavarësisht se, përfshirja e të rinjve në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit është çështje prioritare e agjendës së Qeverisë, ende të rinjtë në zonat rurale përballen me sfida të shumta të cilat i shtynë drejt largimit nga fshati dhe angazhimit në aktivitete bujqësore dhe turistike. Kjo situatë kërkon identifikimin dhe zbatimin e mënyrave praktike për t'i mbështetur dhe motivuar të rinjtë në sipërmarrjen turistike duke u bazuar në këto arsye:

- Për të ndaluar largimin e të rinjve nga fshati dhe krijimi i kushteve për të inkurajuar kthimin e atyre që janë larguar me qëllim qëndrueshmërinë e jetës dhe ekonomisë rurale.
- Të rinjtë sjellin ide të reja dhe novatore të cilat mund të diversifikojnë dhe përmirësojnë shërbimet dhe aktivitetet turistike në zonat rurale dhe malore.
- Qëndrueshmëria e jetës dhe ekonomisë në zonat rurale varet nga angazhimi aktiv i të rinjve.
- Angazhimi i të rinjve në sipërmarrje turistike ndihmon në punësimin e forcës aktive të punës dhe rrit të ardhurat në komunitetet rurale.
- Përfshirja e të rinjve përforcon imazhin pozitiv të zonave rurale dhe malore si destinacione turistike tërheqëse.
- Turizmi rural dhe malor ka potencialin të kthehet në një platformë për edukim dhe vetkulturim të të rinjve, duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore të komuniteteve vendore.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Skema mbështetëse financiare përmes programeve që adresojnë nevojat specifike të të rinjve në zonat rurale dhe malore.
2. Mundësimi i kredive me interesa të ulëta për të rinjtë që synojnë të investojnë në turizmin rural dhe aktivitetet mbështetëse.
3. Ofrimi i trajnimeve në tematika të tilla si mikpritja, guidat turistike, menaxhimi i sipërmarrjeve turistike dhe shërbimet.
4. Ndërmarrja e nismës “Rinia Rurale Strategjike” që ka në fokus të rinjtë e zonave rurale si aset strategjik për zhvillimin rural, duke ofruar mbështetje për nxitjen e tyre në sipërmarrje.
5. Krijimi i skemave nxitëse për të stimuluar punësimin e të rinjve nga zonat rurale në sipërmarrjen rurale, duke ofruar incentiva për të nxitur rikthimin e të rinjve në fshat.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministri për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Institucionet e varësisë: Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit.
- Sektori i shoqërisë civile, media dhe donatorë.

Deklaratë:

Pavarësisht pritshmërive të larta të shoqërisë ndaj të rinjve, ata ende nuk kanë mundësitë dhe kapacitetet për përmbushur rolin dhe për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik. Në mungesë të instrumenteve efektive që adresojnë nevojat specifike që kanë të rinjtë në zonat rurale, ata do të largohen nga fshati në përpjekje për të gjetur cilësi më të mirë të jetesës dhe mundësi punësimi. Prandaj është prioritarë krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për mbështetjen e të rinjve në zonat rurale përmes politikave financiare, trajnimeve dhe incentivave për punësim dhe sipërmarrje turistike, por jo vetëm. Vetëm përmes këtyre masave mund të frenohet migrimi nga zonat rurale dhe të inkurajohet përfshirja e të rinjve në turizmin rural.

TEMATIKA: QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE

REKOMANDIMI 7: NDËRTIMI NË HARMONI ME MJEDISIN

Ne besojmë se ndonëse ka pasur vazhdimisht nisma ligjore dhe rregullatore në lidhje me ndërtimet në harmoni me mjedisin, zbatimi i tyre ka qenë shpesh i pamjaftueshëm, ndaj rikthimi i vëmendjes ndaj ndërtimit që respekton mjedisin dhe natyrën, veçanërisht në zonat rurale dhe malore, është i rëndësishëm sepse:

- Së pari, ndërtimi në harmoni me mjedisin kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e tij dhe të resurseve dhe pasurive natyrore, të cilat janë të përqendruara në zona rurale dhe malore.
- Së dyti, duke mbrojtur mjedisin dhe natyrën nga ndërtimet invazive dhe tjetërsuese, ndihmojmë në mbrojtjen e stilit të jetesës dhe trashëgimisë social-kulturore të zonave rurale dhe malore.
- Së treti, kombinimi i dy të parave na jep garanci për të ardhmen, duke mos ndërtuar (menduar) sot për sot, por duke menduar vazhdimësinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm që merr në konsideratë nevojat e brezave të ardhshëm.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Hartimi dhe monitorimi i planeve urbanistike, duke vendosur ndërtimin në harmoni me mjedisin në zonat rurale dhe malore si përparësi për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.
2. Përforcimi dhe fuqizimi i strukturave ligjzbatuese për të parandaluar ndërtime që dëmtojnë mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale dhe malore.
3. Vendosja (nëse nuk ka) dhe zbatimi me përpikmëri i raporteve ndërtime – hapësirë – burime, për të parandaluar mbindërtimin dhe dëmtimin e burimeve dhe pejsazhit.
4. Për ndërtime të mëdha, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në komunitetet lokale ose natyrën e zonës, të sigurohet konsultim i komuniteteve vendore si pjesë e procesit të vendimmarrjes. Për ndërtime më të vogla, plani rregullator është i mjaftueshëm për të garantuar përputhshmërinë me rregullat dhe standardet.
5. Krijimi i mekanizmave për nxitjen e sinjalizimit të hershëm të ndërtimeve që nuk respektojnë rregullat e mjedisit dhe zhvillimin e zonave rurale dhe malore, dhe ofrimi i mbështetjes për qytetarët që raportojnë shkeljet.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore dhe institucionet e varësisë: Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Zhvillimin e Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Policia e Shtetit.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë e vendit.

Deklaratë:

Parandalimi i ndërtimeve që ndikojnë negativisht në mjedisin, pasuritë natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale dhe malore me potencial turistik është domosdoshmëri. Nxitja dhe monitorimi i ndërtimeve që respektojnë mjedisin, pasuritë e zonave dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre mund të arrihet përmes planifikimit, zbatimit, si dhe monitorim dhe vlerësimit të plotë dhe të qëndrueshëm. Këto përpjekje kërkojnë angazhim dhe mirëkoordinim të të gjithë aktorëve nga pushteti qendror e vendor, deri tek qytetarët e thjeshtë që duhet të nxiten të sinjalizojnë ndërtimet që nuk janë në harmoni me mjedisin për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të mirëkoordinuar në këto zona.

REKOMANDIMI 8: NXITJA E PËRDORIMIT TË BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT MALOR DHE RURAL NË SHQIPËRI

Ne besojmë se çështja e krijimit të lehtësirave për zhvillimin e burimeve alternative të energjisë është e rëndësishme sepse

- Së pari, energjetika qëndron në themel të zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Në Shqipëri, varësia nga burimet tradicionale të energjisë, kryesisht hidrocentrale dhe energji e importuar, rrit paqëndrueshmërinë dhe ekspozon vendin ndaj krizave energjetike të shpeshta, të përkthyer në mungesë energjie ose çmime të papërbalueshme nga operatorët e vegjël turistikë.
- Së dyti, investimi në burime alternative si energjia diellore, eolike, dhe të tjera mund të ulë koston e energjisë në afat të gjatë, duke kompensuar koston e investimeve fillestare të këtyre burimeve, si dhe uljen e varësisë nga blerjet e shtrenjta të energjisë nga rrjeti dhe të promovojë konkurrencën në tregun energjetik, edhe në rrafshin individual.
- Së treti, zhvillimi dhe përhapja e burimeve alternative të energjisë e bën një biznes më të sigurt në situata emergjente, kur furnizimi nga burimet tradicionale mund të bjerë për shkak të krizave klimatike, gjeopolitike ose edhe defektet e shpeshta në një rrjet të amortizuar.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Parlamenti i Shqipërisë duhet të miratojë një ligj specifik për energjinë e rinovueshme që përfshin titujt individualë për qytetarët dhe bizneset që dëshirojnë të investojnë në burime alternative të energjisë, si panele diellore dhe turbinat eolike të shkallës së vogël. Ky ligj duhet të përfshijë incentiva për individët që prodhojnë më shumë energji sesa konsumojnë dhe mund të shesin energjinë e tepërt në rrjetin kombëtar.
2. Legjislacioni duhet të lehtësojë hyrjen e operatorëve privatë në tregun e energjisë për të rritur konkurrencën dhe për të ofruar alternativa të qëndrueshme për konsumatorët. Krijimi i

lehtësirave rregullatore për startup-et në sektorin e energjisë do të promovojë inovacionin dhe përhapjen e teknologjive të reja edhe në sektorin turistik, për sa kohë investimet mund të jenë ndërsektoriale në natyrë ku të ardhurat e njërit segment të biznesit mbështesin segmentin tjetër.

3. Qeveria e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare si Banka Botërore, BE, dhe UNDP, duhet të krijojë programe subvencionimi për projektet energjetike të qëndrueshme. Këto programe duhet të ndihmojnë individët dhe bizneset në uljen e kostove fillestare për instalimin e paneleve diellore, turbinave të erës dhe teknologjive të tjera të rinovueshme.
 - » Zonat rurale me rrezik më të madh nga krizat energjetike duhet të përfitojnë subvencione më të larta përmes subvencionimit të lokalizuar, duke inkurajuar instalimin e burimeve të decentralizuara të energjisë që përmirësojnë jetesën dhe sigurinë energjetike në ato zona.
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me institucionet lokale dhe ato të varësisë, duhet të thjeshtëzojë procedurat administrative për qytetarët dhe bizneset që duan të investojnë në energji alternative. Një portal i vetëm online për licencim dhe leje për energjinë e rinovueshme në aspektin e prodhimit dhe përdorimit individual (Zyra me një Ndalesë) do të lehtësonte procesin për të gjithë aplikantët.
5. Qeveria shqiptare duhet të ofrojë garanci sovraane për investime në projekte të energjisë së rinovueshme edhe në rrafshin individual, jo vetëm tek ai masiv. Kjo garanci do të krijojë besim midis investitorëve potencialë dhe operatorëve aktual në sektorin turistik, duke siguruar që këto projekte të kenë mbështetje financiare të qëndrueshme përmes granteve financiare apo kredive afatgjata të siguruara. Projektet që përfshijnë energjinë diellore ose të erës duhet të jenë të mbështetura nga garanci për të mbuluar rrezikun e mungesës së kthimit të investimit tek operatorët e mesëm dhe të vegjël, në të njëjtën formë dhe mënyrë siç veprohet me investitorët strategjikë.
6. OSHEE duhet të lidhë kontrata me prodhuesit e vegjël të energjisë alternative. Këto kontrata do të sigurojnë që çdo prodhues që gjeneron energji të tepërt mund ta shesë atë në rrjet, duke krijuar një sistem energjetik më fleksibël dhe të decentralizuar. Prodhuesit e energjisë nga panelet diellore në banesa ose bizneset e vogla mund të përfitojnë financiarisht nga ky lloj modeli duke shtuar dhe qëndrueshmërinë financiare të këtyre bizneseve.

Deklaratë:

Ne rekomandojmë që Shqipëria të ndërmarrë një strategji të plotë dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e burimeve alternative të energjisë, që përfshin:

- Miratimin e legjislacionit të përshtatshëm për titujt individualë dhe incentivimin e sektorit privat.
- Subvencionimin e projekteve të energjisë së rinovueshme, me fokus në zonat rurale dhe të margjinalizuara.
- Thjeshtimin e procedurave administrative dhe krijimin e një portali të centralizuar online për lejet dhe licencat energjetike.
- Zhvillimin e një fuqie punëtore të specializuar në teknologjitë e energjisë së gjelbër përmes programeve arsimore dhe trajnimeve profesionale.

Ne mendojmë se këto hapa do të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm energjetik edhe në sektorin turistik në zona të izoluara, do të ulë kostot në afat të gjatë, dhe do të ndihmojë Shqipërinë të arrijë një tranzicion të qëndrueshëm dhe të drejtë drejt burimeve alternative të energjisë dhe një pavarësi nga burimet tradicionale si dhe ato me një shenjë (footprint) të madhe mjedisore.

REKOMANDIMI 9: NDALIMI I NDËRTIMIT TË HEC-EVE NË SHQIPËRI

Ne besojmë se çështja e ndalimit të hidrocentraleve (HEC-eve) është një çështje e rëndësishme për disa arsye, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Disa nga arsyet kryesore për rëndësinë e ndalimit të ndërtimit të HEC-eve janë:

- Së pari, ndërtimi i hidrocentraleve shpesh ndikon negativisht në ekosistemet natyrore, duke prishur rrjedhën e lumenjve dhe duke dëmtuar habitatet e specieve të ndryshme bimore dhe shtazore. Lumenjtë janë vendbanime kritike për shumë organizma, dhe ndryshimet e mëdha në rrjedhën dhe temperaturën e ujit mund të dëmtojnë biodiversitetin.
- Së dyti, lumenjtë janë burim jetik për komunitetet lokale, veçanërisht për bujqësinë, peshkimin dhe përdorimin e ujit për konsum të përditshëm. Ndërtimi i HEC-eve mund të zvogëlojë sasinë e ujit të disponueshëm dhe cilësinë e tij, duke ndikuar negativisht jetesën e banorëve dhe ekonominë lokale.
- Së treti, shumë nga vendet ku planifikohen HEC-e ndodhen në zona natyrore të mbrojtura, të cilat janë të rëndësishme jo vetëm për biodiversitetin, por edhe për zhvillimin e turizmit natyror. Ndërtimi i HEC-eve mund të dëmtojë potencialin turistik të këtyre zonave, duke ulur mundësitë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet turizmit natyror.
- Së katërti, megjithëse HEC-et nuk prodhojnë gazra serë drejtpërdrejt, ato mund të kontribuojnë në ndryshime klimatike lokale për shkak të ndryshimit të mikroklimës në zonat përreth dhe rrezikut të emetimeve të gazrave të tjerë të dëmshëm nga mbeturinat organike të grumbulluara në rezervuarët e tyre.
- Së pesti, ndërtimi i HEC-eve mund të dëmtojë zonat me rëndësi kulturore dhe historike për komunitetet lokale, duke shkaktuar zhvendosje të popullatës dhe shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. Ndalimi i ndërtimit të HEC-eve në këto zona është kritik për ruajtjen e traditave dhe identitetit lokal.
- Së gjashti, ka zgjidhje të tjera alternative për prodhimin e energjisë së rinovueshme që kanë më pak ndikim në mjedis, siç janë energjia diellore dhe ajo e erës. Investimi në këto alternativa mund të zvogëlojë nevojën për HEC-e dhe të ndihmojë në ruajtjen e lumenjve dhe ekosistemeve natyrore.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme

1. Rishikimi i licencave ekzistuese të lëshuara për HEC-e duke bërë një rishikim të plotë të tyre, për të vlerësuar ndikimin e tyre në mjedis dhe komunitetet lokale. Në rastet kur licencat janë dhënë në mënyrë jo të rregullt ose me ndikim të madh negativ, të anulohen.
2. Krijimi i ligjeve më të ashpra për mbrojtjen e lumenjve që mbrojnë rrjedhën natyrore të tyre, sidomos për zonat e mbrojtura dhe me rëndësi të lartë ekologjike.
3. Forcimi i kontrolleve dhe sanksioneve për ndërtuesit që nuk respektojnë kushtet mjedisore të vendosura në licencat e tyre.
4. Shpallja e lumenjve me rëndësi të veçantë mjedisore të mbrojtur si Vjosa, si parqe kombëtare ose zona të mbrojtura, duke penguar ndërtimin e çdo lloji HEC-i.
5. Të hartohen studime që identifikojnë zonat ku HEC-et kanë ndikim më të madh dhe të ndalohet ndërtimi i tyre në këto vende.
6. Promovimi i burimeve alternative të energjisë duke mbështetur investimet në energji të erës dhe energji diellore dhe duke u dhënë përparësi projekteve që kanë më pak ndikim në mjedis krahasuar me HEC-et.

7. Ofrimi i subvencioneve dhe stimujve fiskal për kompanitë që zgjedhin të investojnë në energji diellore dhe energji të erës në vend të ndërtimit të HEC-eve.
8. Organizimi i proceseve të konsultimit publik për të siguruar që komunitetet lokale të përfshihen në vendimmarrje mbi projektet energjetike që prekin mjedisin dhe jetesën e tyre.
9. Përforcimi i rolit të sektorit të shoqërisë civile dhe aktivistëve mjedisorë: Organizatat mjedisore duhet të mbështeten dhe të kenë një zë të fortë në monitorimin e projekteve dhe advokimin për mbrojtjen e lumenjve.
10. Organizimi i fushatave publike ndërgjegjësuese për të informuar qytetarët mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit me fokus lumenjtë dhe efektet e dëmshme të HEC-eve.
11. Të promovohet edukimi mbi energjinë e qëndrueshme në shkolla dhe universitete, për të krijuar breza të rinj më të vetëdijshëm për çështjet mjedisore.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Komisioni Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili ka përgjegjësinë për të rishikuar dhe miratuar ligje që lidhen me politikën mjedisore dhe energjetike. Ai duhet të ndihmojë në krijimin e një kornize ligjore që ndalon ndërtimin e HEC-eve në zona me rëndësi natyrore dhe ekologjike.
- Qeverisja qendrore: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore në Shqipëri, duke përfshirë menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe monitorimin e ndikimit mjedisor të projekteve energjetike, përfshirë HEC-et.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministria përgjegjëse për politikën e energjisë që duhet të promovojë burime të rinovueshme të energjisë që kanë më pak ndikim në mjedis. Ajo gjithashtu duhet të luajë një rol në rishikimin dhe refuzimin e licencave për HEC-et që dëmtojnë ekosistemet natyrore.
- Institucione të varësisë: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) e cila luan një rol kyç në mbrojtjen e zonave natyrore dhe monitorimin e projekteve që ndikojnë në to.
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave që ka për detyrë të monitorojë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe të marrë masa ndaj ndotësve apo projekteve që shkelin rregulloret mjedisore. Inspektorati duhet të forcojë kontrollin për ndërtimet e HEC-eve që cenojnë mjedisin.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe monitorimin e burimeve natyrore të Shqipërisë. Ky institucion duhet të sigurojë që burimet e ujit të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të mos përdoren për projekte që dëmtojnë mjedisin dhe komunitetet.

Deklaratë:

Duke marrë në konsideratë që ndërtimi i hidrocentraleve ndikon negativisht në ekosistemet natyrore, burimet e jetesës së komuniteteve lokale, potencialin turistik të komuniteteve rurale dhe malore, duke tkurrur mundësitë e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht në turizmin natyror, planifikimi i tyre kërkon një qasje të kujdesshme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Ndalimi i ndërtimit të HEC-eve në Shqipëri kërkon veprime të koordinuara midis qeverisë, institucioneve përkatëse dhe komuniteteve lokale, si dhe zbatimin e një kornize të qartë ligjore dhe politike për mbrojtjen e lumenjve dhe ekosistemeve natyrore.

REKOMANDIMI 10: FUNKSIONIMI EFEKTIV I MENAXHIMIT TË MBETJEVE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT MALOR

Ne besojmë se çështja e menaxhimit të mbetjeve është e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural dhe malor sepse:

- Ndhmon në eliminimin e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit duke mbrojtur në këtë mënyrë shëndetin publik të popullsisë lokale, vizitorëve dhe turistëve.
- Mbron mjedisin dhe ekosistemet, duke ruajtur burimet natyrore dhe biodiversitetin nga ndotja, çka është e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe nevojat e brezave të ardhshëm.
- Atraktiviteti turistik i zonave rurale dëmtohet nga mbeturinat e hedhura pa kriter. Bukuria natyrore e zonave rurale dhe malore është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal përmes turizmit.
- Ambienti i pastër promovon një imazh pozitiv të komunitetit duke inkurajuar ndjenjën e përkatësisë të popullsisë lokale. Gjithashtu, ai nxit jetën sociale, ekonominë lokale dhe mirëqenien e popullsisë vendase.
- Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve gjeneron vende pune në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve duke krijuar në këtë mënyrë përfitime.
- E drejta për të jetuar në një mjedis të pastër është e drejtë themelore njerëzore dhe menaxhimi i mbetjeve ndihmon në respektimin e saj.

Për të adresuar këtë çështje ne besojmë se janë të nevojshme dhe të përshtatshme veprimet e mëposhtme:

1. Funkcionimi i një sistemi të unifikuar të menaxhimit të mbetjeve me ndarje në burim, në të gjithë vendin.
2. Përmirësimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, duke mundësuar që sistemi të jetë funksional dhe i qëndrueshëm.
3. Zgjerimi i shërbimit të pastrimit duke siguruar mbulimin e zonave rurale me shërbimin e pastrimit, për të mbrojtur mjedisin dhe përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në këto zona.
4. Realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve dhe të gjitha strukturave institucionale për qëndrueshmërinë e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.
5. Promovimi i praktikave të mira dhe ekologjike në nivel individual, biznesi apo ferme dhe komuniteti për të reduktuar ndotjen dhe përmirësuar menaxhimin e mbetjeve.
6. Forcimi i kontrolleve dhe monitorimeve në terren për të evidentuar ndotjet dhe për të zbatuar penalizime ndaj ndotësve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në të njëjtën kohë, forcimi i integritetit të administratës publike ligjzbatuese të mjedisit është prioritet.
7. Krijimi dhe zbatimi i skemave nxitëse për të mbështetur nisma komunitare për pastrimin e lumenjve, pyjeve dhe hapësirave publike.
8. Krijimi i instrumenteve novatore për përfshirjen e publikut në mbrojtjen e mjedisit përmes krijimit të një platforme digjitale për denoncimin e ndotjeve nga qytetarë.

Këto veprime/masa duhet të ndërmerren nga:

- Qeverisja qendrore: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri për Çështjet Lokale, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.
- Institucionet e varësisë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore: 61 bashkitë.
- Sektori i shoqërisë civile, media, sektori privat dhe donatorë.

Deklaratë:

Ndotja e mjedisit nga mbetjet e hedhura pa kriter ende mbetet një pengesë serioze për zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin rural në Shqipëri. Pa një sistem të unifikuar dhe funksional të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin, komunitetet rurale do të përballen me ndotje të tokës, ujit dhe ajrit, duke përkeqësuar cilësinë e jetesës dhe mundësitë ekonomike të tyre. Nëse kjo çështje nuk merr vëmendjen e duhur, ndotja e vazhdueshme do të ulë numrin e vizitorëve dhe turistëve, duke tkurrur të ardhurat lokale dhe nxitur braktisjen e zonave rurale. Prioriteti kryesor është krijimi i një sistemi të integruar për menaxhimin e mbetjeve, që mbulon gjithë zonat rurale, përmes investimeve në infrastrukturën (e sistemit të menaxhimit të mbetjeve), edukimit dhe angazhimit të qytetarëve, dhe kontrolleve dhe penalizimeve efektive. Vetëm duke investuar në këtë drejtim do të mundemi të kontribuojmë pozitivisht në ruajtjen e bukurive natyrore dhe atraktivitetit të komuniteteve rurale duke krijuar kushte për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe ekonomisë lokale.